



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Datë: 24/02/2025

Ref: 221/2025

E nderuar familja Qerkini,

Me pikëllim morëm lajmin për ndarjen nga jeta të bacit Bajram, shembull i përkushtimit në kërkimin e së vërtetës për të zhdukurit gjatë luftës.

Bajram Qerkini ishte simbol i forcës dhe durimit të prindit. Si kryetar i shoqatës "Zëri i Prindërve", ai e shndërroi dhimbjen e tij personale në kauzë të përbashkët. Ai u angazhua edhe në nivel institucional, si përfaqësues i shoqatave të familjarëve në Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në emrin tim ju shpreh ngushëllime juve, familjes, miqve dhe të gjithë atyre që e njohën dhe që ndanë rrugëtimin me të.

Kontributi i tij do të mbetet në kujtesën tonë kolektive për dedikimin ndaj humanizmit dhe do të shërbejë si frymëzim në përpjekjet për çështjen e të zhdukurve me dhunë gjatë luftës në Kosovë.

Me respekt,

Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës